

Analiza e rastit “Drenica”

Rasti “Drenica” është një nga rastet më të mëdha të gjykuara nga gjyqësori vendor për krime lufte kundër popullatës civile, ku të akuzuarit kanë qenë pjesëtarë të UÇK-së. Edhe pse pjesa më e madhe e aktakuzës ka marrë formën e prerë, një pikë e aktakuzës ende është në proces gjyqësor.

Ky rast fillimisht është hetuar dhe gjykuar nga misioni i EULEX-it, dhe pas përfundimit të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në vitin 2018, është transferuar te gjyqtarët dhe prokurorët vendorë.

Rrjedha e procedurës penale

Më 6 nëntor 2013, pas përfundimit të hetimeve, prokurori special i EULEX-it ngriti aktakuzën me numër PPS.nr.88/11 për krime lufte kundër popullatës civile, ndaj Agim Demaj, Bashkim Demaj, Driton Demaj, Selman Demaj, Fadil Demaku, Jahir Demaku, Nexhat Demaku, Zeqir Demaku, Sabit Geci, Ismet Haxha, Sahit Jashari, Sami Lushtaku, Sylejman Selimi, Isni Thaqi dhe Avni Zabeli.

Sipas aktakuzës, veprat penale janë kryer gjatë kohës së konfliktit të armatosur në rajonin e Drenicës, në qendrën e ndalimit të UÇK-së në Likoc/Likovac në të cilën janë mbajtur civilët, kryesisht shqiptarë për të cilët është dyshuar se kanë bashkëpunuar me pushtetin serb si dhe disa serb. Të ndaluarit pasi që janë privuar nga liria, u janë nënshtruar rrahjeve, formave të tjera të cenimit të integritetit trupor dhe shëndetit, vrasjeve dhe formave të tjera të trajtimit çnjerëzor.

Pas konfirmimit të aktakuzës, me aktvendimin e datës 14 prill 2014 të kryetarit të trupit gjykues të Gjykatës Themelore në Mitrovicë/Mitrovica, aktakuza me numër PPS.nr.88/11 ishte ndarë në dy lëndë: në lënda *Prokurori kundër Sabit Gecit dhe të tjerëve (Drenica I)*¹ dhe lënda *Prokurori kundër Agim Demaj dhe të tjerëve (Drenica II)*².

Gjykimi për këto dy lëndë ka filluar në vitin 2014 pranë Gjykatës Themelore të Mitrovicës/Mitrovica të përbërë nga gjyqtarë ndërkombëtarë të misionit të EULEX-it.

Në dy procedura të ndara gjyqësore në total janë mbajtur rreth gjashtëdhjetë e gjashtë (66) seanca të shqyrtimit kryesor.

Në rastin “Drenica I” janë dëgjuar gjashtëmbëdhjetë (16) dëshmitarë të propozuar nga prokuroria, tre (3) dëshmitarë të propozuar nga mbrojtja dhe dy (2) dëshmitarë të propozuar ex-officio nga trupi gjykues. Kurse në rastin “Drenica II” janë dëgjuar shtatë (7) dëshmitarë të propozuar nga

¹ Të bashkëakuzuarit: Sahit Jashari, Jahir Demaku, Sylejman Selimi, Ismet Haxha, Sami Lushtaku dhe Avni Zabeli.

² Të bashkëakuzuarit: Bashkim Demaj, Driton Demaj, Selman Demaj, Fadil Demaku, Jahir Demaku, Nexhat Demaku, Zeqir Demaku, Sylejman Selimi dhe Isni Thaqi.

prokuroria dhe tetë (8) dëshmitarë të propozuar nga mbrojtja.

Pjesa më e madhe e dëshmitarëve të propozuar nga prokuroria kanë qenë dëshmitarë ndaj të cilëve gjykata ka caktuar masën e anonimitetit, ku këta dëshmitarë kanë dëshmuar me pseudonime dhe ajo çka ka qenë e veçantë në këtë procedurë është se për herë të parë në praktikën gjyqësore në Kosovë, gjykata disa prej dëshmitarëve me propozim të prokurorisë i ka shpall si “dëshmitarë armiqësor”, pra ata dëshmitarë të cilët kanë dëshmuar në kundërshtim me ato çfarë kanë dëshmuar në procedurën hetimore gjatë dhënies së deklaratës në prokurori. Me shpalljen e “dëshmitarit armiqësor”, prokuroria ka të drejtë ta merr në pyetje dëshmitarin e vetë përtej kornizave të pyetjeve të drejtpërdrejta, pra t’i parashtron pyetjet edhe në mënyrë të tërthortë.

Duke pasur parasysh se këto dy lëndë janë gjykuar ndaras dhe kanë marrë formë të prerë, për maltretimin e të ndaluarve si krim luftime janë shpallur fajtorë Agim Demaj, Bashkim Demaj, Driton Demaj, Selman Demaj, Fadil Demaku, Jahir Demaku, Nexhat Demaku, Zeqir Demaku, Sylejman Selimi dhe Isni Thaqi, të cilët janë dënuar me nga 3 deri në 8 vite burgim, ndërsa të tjerët janë liruar nga akuzat. Të pandehurit janë shpallur fajtorë sepse gjatë kohës së konfliktit të armatosur në Kosovë në një datë të pasaktësuar gjatë muajve gusht dhe shtator të vitit 1998, në cilësinë e pjesëtarëve të UÇK-së, në bashkëkryerje reciprokisht si edhe me pjesëtarë të tjerë të pidentifikuar të UÇK-së me qëllim e kanë zbatuar dhunën, trajtimin e vrazhdë dhe çnjerëzor dhe torturën ndaj dëshmitarëve A dhe B (civil shqiptarë nga Kosova), të cilën kanë qenë të ndaluar në hapësirat e qendrës së ndalimit në Likoc/Likovac.

Rigjykim i pjesshëm i rastit “Drenica I”

Pas paraqitjes së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nga mbrojtja e Sylejman Selimit, Gjykata Supreme, me aktgjykimin e datës 11 qershor 2018, e pranoi pjesërisht kërkesën e tij, duke konstatuar se trupi gjykues i Gjykatës Themelore në Mitrovicë/Mitrovica ishte përbërë në mënyrë jo legjitime. Si rezultat, lënda iu kthye kësaj gjykate për rigjykim.

Lënda në rigjykim është kthyer vetëm kundër të pandehurve Sylejman Selimi dhe Jahir Demaku, për pikën që ka të bëjë me cenimin e integritetit trupor dhe shëndetin e një personi të pidentifikuar nga lagjja Shipol/Šipolje e Komunës së Mitrovicës/Mitrovica, i cili ishte ndaluar në qendrën e ndalimit në Likoc/Likovac, dhe ishte rrahur në mënyrë të përsëritur. Për të gjithë të akuzuarit e tjerë të përfshirë në aktakuzën PPS.nr.88/11, aktgjykimet kanë marrë formën e prerë dhe rastet janë mbyllur.

Gjykata Themelore në Mitrovicë/Mitrovica ka caktuar tri (3) seanca për rigjykim të çështjes por asnjëra nuk është mbajtur për arsye të ndryshme.

Gjykata Themelore në Mitrovicë/Mitrovica, që nga marrja e kompetencave ekzekutive nga misioni i EULEX-it në qershor 2018, ka dështuar të sigurojë një proces të rregullt gjyqësor për këtë rast, si dhe për raste të tjera të krimeve të luftës që duhej të trajtoheshin nga kjo gjykatë.

Në takimin e 319 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), të mbajtur në datën 25 janar të vitit 2024, i cili është transmetuar edhe drejtpërdrejtë në rrjetin social Facebook të faqes zyrtare të KGJK, kryetarja e Gjykatës Themelore të Prishtinës/Priština e ka aprovuar transferimin e trembëdhjetë (13) lëndëve nga Gjykata Themelore e Mitrovicë/Mitrovica në Gjykatën Themelore të Prishtinës/Priština, dhe në mesin e këtyre lëndëve janë edhe lëndët për krimet e luftës kundër popullatës civile.

Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priština, pas pranimit të rastit kundër Selimit dhe Demakut, menjëherë në datën 12 prill 2024 ka proceduar me shqyrtim gjyqësor.

Në rigjykim ky rast është trajtuar nga prokurorë³ dhe gjyqtarë⁴ vendor, pasi që nga qershori i vitit 2018, kompetencat për trajtimin e këtyre rasteve kanë kaluar tek gjyqësori vendor.

Në rigjykim janë mbajtur dy (2) seanca të shqyrtimit kryesor. Në datën 12 prill 2024 është bërë leximi i aktakuzës lidhur me pikën e cila është kthyer në rigjykim. Të pandehurit janë deklaruar të pafajshëm.

Pas paraqitjes së fjalëve hyrëse nga palët në procedurë, procedura ka vazhduar me administrimin e provave.

Avokati Artan Qerkini mbrojtës i Sylejman Selimit ka propozuar që deklaratat e dëshmitarit “A” të merren si të lexuara në këtë shqyrtim gjyqësor, prokuroria dhe mbrojtja e Demakut janë pajtuar me këtë propozim.

Pas këtij propozimi trupi gjykues mori vendimin që deklaratat e dëshmitarit “A” të dhëna në prokurori në datën 13 dhjetor 2011 dhe ato të dhëna në shqyrtimin gjyqësorë të mbajtur në datat 25 qershor 2014, 17 korrik 2014 dhe 18 korrik 2014 janë pranuar si të lexuara.

Prokuroria deklaroi se nuk ka prova të tjera të cilat e mbështesin aktakuzën, përveç se gjatë shqyrtimi kryesor është marrë si e lexuar prova materiale lidhur me aplikacionin e dëshmitarit “A” për njohje të statusit të veteranit, pjesëtarit dhe të internuarit të luftës së UÇK-së.

Pasi që palët nuk patën propozime të tjera për dëgjimin e ndonjë dëshmitari apo propozime shtesë të provave, procedura e provave është mbyllur. Të pandehurit kanë mbetur pranë deklaramëve të dhëna në gjykimin e kaluar dhe kanë shfrytëzuar të drejtën për t’u mbrojtur në heshtje.

Në datën 22 prill 2024 janë dhënë fjalët përfundimtare të palëve në procedurë.

Në datën 25 prill 2024, trupi gjykues i Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priština e shpalli aktgjykimin lirues për të dy të pandehurit për akuzën e cila është kthyer

³ Lënda në rigjykim pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës/Priština, është përfaqësuar nga prokurorja speciale Florije Salihu Shamolli.

⁴ Trupi gjykues ka qenë i përborë nga Ngadhnjim Armi si kryetar i trupit gjykues, Mentor Bajraktari dhe Lutfi Shala anëtarë të trupit gjykues.

në rigjykim.

Arsyeja se pse gjykata nuk i besoi deklaratave të dëshmitarit “A” ishte se dëshmia e tij përmbante shumë kundërthënie dhe nuk mbështetej nga asnjë provë tjetër që mund të rehabilitonte këto kundërthënie.

Gjetjet e FDHK:

-Gjykata Themelore në Mitrovicë/Mitrovica ka dështuar të trajtoj rastet e krimeve të luftës të trashëguara nga misioni i EULEX-it, pas përfundimit të mandatit ekzekutiv të këtij misioni në qershor 2018.

-Këshilli Gjyqësor i Kosovë ka marrë një vendim të drejtë, edhe pse të vonuar, që rastet e krimeve të luftës, të cilat kanë qenë duke qëndruar pezull për më shumë se pesë (5) vite, të transferohen pranë Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priština.

-Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priština është treguar mjaftë ekspeditiv në trajtimin e rastit *Prokurori kundër Sylejman Selimit dhe Jahir Demakut*.

-Aktvendimi i trupit gjykues për të marrë si të lexuara deklaratat e dëshmitarit “A” të dhëna në shqyrtimin kryesor pranë Gjykatës Themelore të Mitrovicës/Mitrovica është mjaft i diskutueshëm. Ky vendim ngre pyetje për ligjshmërinë e këtyre deklaratave, duke pasur parasysh se ato janë dhënë para një trupi gjykues që, sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme, ishte përbërë në mënyrë joligjore, çka çoi në kthimin e çështjes për rigjykim. Pavarësisht kësaj, ky trup gjykues kishte konstatuar se deklaratat e dëshmitari “A” përmbanin shumë kundërthënie, dhe prandaj, në këtë shqyrtim kryesor, do të duhej që në këtë shqyrtim kryesor dëshmitari të ballafaqohej me të gjitha këto kundërthëniet. Kjo ishte veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh se më herët Gjykata e Apelit, duke u bazuar në këto deklarata, kishte marrë një vendim fajësues.

-Gjetjet e tjera lidhur me rastet “Drenica I” dhe “Drenica II” mund të gjenden në raportet vjetore të FDHK-së, të publikuara gjatë viteve 2013-2018, në faqen zyrtare të FDHK-së: www.hlc-kosovo.org.

Ky publikim përkrahet financiarisht nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës përmes projektit “Avancimi i procesit të pajtimit përmes qasjes përfshirëse dhe holistike ndaj ballafaqimit me të kaluarën në Kosovë” dhe nga organizata “National Endowment for Democracy” përmes projektit të quajtur “Promovimi i dialogut dhe të kuptuarit historik”.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës dhe organizatës “National Endowment for Democracy”.